

20080841556

L I G J
PËR REZERVAT E DETYRUESHME TË
NAFTËS DHE DERIVATEVE TË NAFTËS

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet formimi, ruajtja, përtëritja dhe shfrytëzimi i rezervave të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës, kompetencat e Drejtorisë për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës, dhe çështje tjera me rëndësi për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës.

Neni 2

(1) Rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës (në tekstin e mëtejshëm: rezervat e detyrueshme) formohen me qëllim të sigurimit të kushteve për furnizimin intervenues të tregut me naftë dhe derivate të naftës, në rast të çrregullimit të sigurisë energjetike të shtetit të shkaktuar nga çrregullimet e furnizimit me përmasa më të mëdha.

(2) Formimi, ruajtja, përtëritja dhe shfrytëzimi i rezervave të detyrueshme të naftës nga paragrafi (1) i këtij neni ka të bëjë me:

- lëndën e parë të naftës,
- të gjitha llojet e benzinës motorike dhe të aviacionit,
- të gjitha llojet e lëndëve djegëse dizel dhe kerozinës,
- EL-vaj për amvisëri,
- TNG, dhe
- mazutit.

Neni 3

Për kryerjen e punëve administrative, profesionale dhe punëve tjera në lidhje me rezervat e domosdoshme të naftës dhe derivateve të naftës themelohet Drejtoria për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës (në tekstin e mëtejshëm: Drejtoria).

II. FORMIMI, RUAJTJA, PËRTËRITJA DHE SHFRYTËZIMI I REZERVAVE TË
DETYRUESHME

Neni 4

(1) Formimi, ruajtja dhe përtëritja e rezervave të detyrueshme të naftës bëhet në bazë të programit afatmesëm dhe vjetor.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e Drejtorisë, e miraton programin afatmesëm për formimin e rezervave të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe blerjen e kapaciteteve për magazinim.

(3) Programi afatmesëm miratohet për periudhë prej pesë vjetësh.

(4) Drejtoria në bazë të programit afatmesëm, miraton programin vjetor për formimin, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e rezervave të detyrueshme, me mendimin e siguruar paraprakisht nga ministria kompetente për punët nga sfera e energjetikës.

(5) Drejtoria me programin vjetor i përcakton llojin, sasinë dhe vlerën e derivateve të naftës të cilat furnizohen dhe përtërihen.

(6) Programi vjetor për vitin e ardhshëm miratohet më së voni deri në fund të vitit në vijim.

Neni 5

(1) Rezervat e detyrueshme formohen gradualisht sipas konsumit të llojeve të veçanta të derivateve të naftës në vitin kalendarik paraprak, në pajtim me Bilancin energjetik të Republikës së Maqedonisë, me çka sasitë e përgjithshme të rezervave të llojit adekuat të derivatit të naftës duhet të arrijnë mbulimin e konsumit mesatar ditor të realizuar të atij derivati të naftës për periudhë prej 90 ditësh në vitin kalendarik paraprak ose 25% nga konsumi i përgjithshëm i realizuar të llojit adekuat të derivatit të naftës në vitin kalendarik paraprak.

(2) Dinamika e formimit të rezervave të detyrueshme përcaktohet në bazë të programit afatmesëm dhe vjetor.

(3) Rezervat e detyrueshme formohen me furnizime të cilat i kryen Drejtoria, në pajtim me ligjin.

Neni 6

Rezervat e detyrueshme mund të formohen dhe të ruhen në formë të lëndës së parë të naftës ose gjysmëproduktit, me ç'rast të plotësohet kushti nga neni 5 i këtij ligji, në përcaktimin e sasive të lëndës së parë të naftës ose gjysmëprodukteve për këtë qëllim, merret parasysh randmani i realizuar prodhimit të derivateve të naftës në vitin paraprak dhe plani i prodhimit të derivateve të naftës për vitin në vijim.

Neni 7

(1) Rezervat e detyrueshme janë të detyruar t'i ruajnë shoqëritë tregtare, të cilat bëjnë përpunimin e lëndës së parë të naftës dhe prodhimin e derivateve të naftës, ose bëjnë importimin e lëndës së parë të naftës, gjysmëprodukteve të lëndës së parë dhe derivateve të naftës dhe kanë licencë për magazinimin e naftës dhe ose derivateve të naftës (në tekstin e mëtejme: shoqëritë tregtare).

(2) Drejtori i Drejtorisë e përcakton mënyrën e shpërndarjes së sasive të rezervave të detyrueshme, të cilat do t'i ruajnë dhe përtërijnë shoqëritë tregtare, në pajtim me lartësinë e kompensimit të paguar nga neni 24 i këtij ligji, si dhe nevojën për shpërndarjen territoriale të rezervave të detyrueshme.

(3) Për ruajtjen dhe përtëritjen e rezervave të detyrueshme, drejtori i Drejtorisë lidh marrëveshje me shoqëritë tregtare.

(4) Me propozimin e drejtorit të Drejtorisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e përcakton lartësinë e kompensimit për ruajtje si dhe kompensimit për evaporim në pajtim me standardet e përcaktuara.

(5) Rezervat e detyrueshme do të ruhen në kapacitete magazinuese personale dhe/ose të huazuara (rezervuarë) në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe/ose në vendet anëtare të UE.

(6) Me përjashtim, pjesë e rezervave të detyrueshme mund të jenë përkohësisht ose në mënyrë të përhershme të magazinuara dhe të ruajtura në vend anëtare e UE, në rast kur në territorin e Republikës së Maqedonisë nuk ka në dispozicion kapacitet për magazinim (rezervuarë) për sasitë e rezervave të detyrueshme nga neni 2 i këtij ligji.

(7) Për ruajtjen e rezervave të detyrueshme jashtë territorit të Republikë së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë merr vendim.

(8) Në bazë të vendimit nga paragrafi 7 i këtij neni, të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në lidhje me magazinimin dhe ruajtjen e rezervave të detyrueshme nga paragrafi 6 i këtij neni rregullohen me marrëveshje bilaterale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe vendit anëtar të UE, në të cilin përkohësisht ose në mënyrë të përhershme magazinohen ose ruhen rezervat e detyrueshme.

Neni 8

(1) Si rezerva të detyrueshme nuk mund të konsiderohen sasitë e lëndës së parë të naftës në naftësjellës.

(2) Si rezerva të detyrueshme nuk mund të llogariten sasitë e derivateve të naftës në prodhimsjellës.

Neni 9

(1) Në rast të çrregullimit të sigurisë energjetike nga neni 1 i këtij ligji, Qeveria e Republikës së Maqedonisë merr vendimin për llojin, sasinë dhe çmimin e derivateve të naftës të cilat do të shiten.

(2) Shitja e derivateve të naftës nga paragrafi 2 i këtij neni, do të bëhet me marrëveshjen për shitblerje të lidhur ndërmjet drejtorit të Drejtorisë dhe shoqatave tregtare, me të drejtën e përparësisë për blerje, në mënyrë proporcionale të pjesës me të cilën marrin pjesë shoqatat tregtare në formimin dhe ruajtjen e rezervave të detyrueshme.

Neni 10

(1) Shoqëritë tregtare nuk guxojnë që rezervat e detyrueshme t'i shfrytëzojnë, tjetërsojnë, ta ndryshojnë qëllimin dhe strukturën e tyre ose në mënyrë tjetër t'i kenë në dispozicion ato pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Drejtoria.

(2) Shoqëritë tregtare nuk guxojnë që mallrat nga rezervat e detyrueshme t'i shfrytëzojnë si mjete për sigurimin e kërkesave ndaj personave të tretë, pengut apo çfarëdo lloji tjetër të sigurimit .

(3) Shoqëritë tregtare janë të detyruara që Drejtorisë ose subjektit të caktuar prej saj t'i mundësojnë kontrollimin e rezervave të detyrueshme dhe ta vënë në kontroll dhe dispozicion dokumentacionin në lidhje me punën me rezervat e detyrueshme.

III. DREJTORIA E REZERVAVE TË DETYRUESHME TË NAFTËS DHE DERIVATEVE TË NAFTËS

Neni 11

(1) Drejtoria është bartëse e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësive në punën me rezervat e detyrueshme dhe është e pavarur në kryerjen e punëve në kompetencat e saj;

(2) Drejtoria për punën e vet i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;

(3) Drejtoria ka cilësinë e personit juridik;

(4) Selia e Drejtorisë është në Shkup.

Neni 12

(1) Me Drejtorinë administron drejtori të cilin e emëron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Për drejtor mund të emërohet personi, i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të ketë kryer së paku arsimin sipëror,

- të ketë së paku pesë vjet përvojë pune nga të cilat dy vjet në pozitën e udhëheqësit, dhe

- të ketë përvojë nga sfera e derivateve të naftës.

Neni 13

(1) Drejtori emërohet me mandat prej katër vjetësh, me mundësinë për rizgjedhje.

(2) Drejtori i Drejtorisë shkarkohet para skadimit të mandatit në rastet në vijim:

- me kërkesën e vet,

- nëse nuk punon dhe vepron sipas ligjit dhe akteve të Drejtorisë ose pa arsye nuk i zbaton vendimet e Këshillit drejtues dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose vepron në kundërshtim me to,

- nëse me punën e tij të pandërgjegjshme dhe të parregullt shkakton shkelje në kryerjen e punëve të Drejtorisë dhe shkakton dëm,

- nëse i shpërfill ose nuk i kryen obligimet me çka do të ndodhin shkelje në kryerjen e veprimtarisë së Drejtorisë,
- nëse nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 14 të këtij ligji, dhe
- nëse në afatet e caktuara nuk i eviton mangësitë ose/dhe sërish ka mangësi dhe/ose ka humbje financiare në punë.

Neni 14

Drejtori i Drejtorisë i kryen punët në vijim:

- e prezanton dhe përfaqëson Drejtorinë,
- e organizon punën dhe udhëheq me shërbimet profesionale të Drejtorisë,
- i zbaton vendimet e Këshillit drejtues dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,
- kujdeset për punën dhe harxhimin e ligjshëm të mjeteve financiare;
- bën përshtatjen e aktiviteteve punuese të Drejtorisë,
- propozon mënyrën e shpërndarjes së sasive të rezervave të detyrueshme, të cilat do t'i ruajnë dhe përtërijnë shoqëritë tregtare,
- propozon program afatmesëm dhe vjetor dhe plan financiar vjetor,
- përpilon raport për punën e Drejtorisë në vitin paraprak,
- i propozon Këshillit drejtues dhe i kryen aktet e përgjithshme për organizimin dhe sistematizimin e Drejtorisë,
- miraton akte individuale për punën e Drejtorisë,
- miraton akte individuale për punën për të punësuarit nga fusha e marrëdhënieve të punës,
- e përcakton mënyrën dhe procedurën për kryerjen e kontrollit mbi zbatimin e marrëveshjeve për ruajtje dhe përtëritje të lidhura me shoqëritë tregtare, dhe
- vendos për çështje tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Neni 15

(1) Drejtori i Drejtorisë është i detyruar që çdo gjashtë muaj t'i dorëzojë raport për punën e vet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(2) Në raportin nga paragrafi (1) i këtij neni drejtori është i detyruar veçanërisht t'i paraqesë të dhënat për llojin dhe vëllimin e punëve të kryera gjatë kryerjes së punëve të Drejtorisë.

(3) Nëse nga raporti për punën vërtetohen mangësi dhe/ose humbje në punën financiare të Drejtorisë, drejtori është i detyruar që të njëjtat t'i mënjanojë në gjashtë muajt e ardhshëm.

Neni 16

Për realizimin e aktiviteteve të veta Drejtoria në pajtim me ligjin mund të shfrytëzojë shërbime të personave juridikë dhe fizikë nga vendi dhe bota, të specializuar për këtë.

Neni 17

(1) Me Drejtorinë udhëheq Këshilli drejtues, i cili përbëhet prej shtatë anëtarësh.

(2) Anëtarët e Këshillit drejtues të Drejtorisë i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Pesë anëtarë të Këshillit drejtues emërohen me propozimin e ministrit kompetent për punët nga sfera e ekonomisë, nga të cilët tre anëtarë me propozimin e shoqërive tregtare. Një anëtar e propozon ministri kompetent për punët nga sfera e financave dhe një anëtar është me propozimin e Komisionit rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë.

(3) Këshilli drejtues nga radhët e anëtarëve emëron kryetar dhe zëvendëskryetar të Këshillit drejtues, në seancën e parë konstituive.

(4) Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat katër vjet me mundësi për rizgjedhje.

Neni 18

Këshilli drejtues i Drejtorisë i ka kompetencat në vijim:

- miraton statutin e Drejtorisë,
- miraton rregulloren e punës së Drejtorisë,
- miraton program vjetor për formimin, ruajtjen dhe përtëritjen e rezervave të detyrueshme,
- përcakton kriteret për mënyrën e shpërndarjes së sasive të rezervave të detyrueshme, të cilat do t'i ruajnë dhe përtërijnë shoqëritë tregtare,
- miraton raportin vjetor për punën, planin financiar vjetor dhe llogarinë vjetore të Drejtorisë,
- i propozon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë program afatmesëm për formimin e rezervave të detyrueshme të derivateve të naftës, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe blerjen e kapaciteteve për magazinim,
- i parashtron Qeverisë propozime për çështje nga fushëveprimi i punës së Drejtorisë,
- i jep Qeverisë propozime për marrjen e vendimeve nga sfera e rezervave të detyrueshme,
- i miraton aktet e përgjithshme për punën e Drejtorisë,
- i shqyrton dhe miraton raportet për aktivitetet e Drejtorisë,
- e propozon lartësinë e kompensimit për ruajtjen dhe evaporimin e rezervave të detyrueshme,
- i ndihmon drejtorit të Drejtorisë me dhënien e mendimeve dhe propozimeve për implementimin programit të punës, dhe
- kryen punë tjera në pajtim me këtë ligj dhe statutin e Drejtorisë.

Neni 19

Punët profesionale, administrative-teknike ndihmëse dhe punët tjera i kryen shërbimi profesional i Drejtorisë.

Neni 20

(1) Me statutin e Drejtorisë rregullohet puna dhe organizimi i Drejtorisë, kompetencat e Këshillit drejtues dhe të drejtorit të Drejtorisë, marrëdhëniet e ndërsjella të drejtorit dhe Këshillit drejtues, si dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Drejtorisë.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë jep pëlqimin për statutin e Drejtorisë.

IV. FINANCIMI

Neni 21

(1) Mjetet që i dedikohen mbulimit të harxhimeve për punën e rregullt të Drejtorisë, formimit, ruajtjes dhe përtëritjes së rezervave të detyrueshme dhe blerjes ose ndërtimit dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve për magazinim, sigurohen nga:

- kompensimi për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës që paguhet gjatë importit të derivateve të naftës dhe gjatë prodhimit të derivateve të naftës;
- mjetet e realizuara në bazë të bashkëpunimit ndërkombëtar të programeve dhe projekteve;
- donacionet e personave juridikë dhe fizikë të vendit dhe të huaj;
- fondacionet dhe dhuratat, dhe
- burimet tjera.

(2) Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të hyra të Drejtorisë dhe paguhen në llogari adekuate të pagimit, në kuadër të llogarisë së arkës.

Neni 22

(1) Rezervat e detyrueshme nga paragrafi 5 i këtij ligji mund të jepen peng për hyrjen në borxh në bankat afariste, për shfrytëzimin e linjave kreditore për financimin e ndërtimit dhe përtëritjen e kapaciteteve të rezervarëve.

(2) Për dhënien peng të rezervave të detyrueshme nga paragrafi 1 i këtij neni vendos Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 23

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e përcakton mënyrën e konfirmimit, përllogaritjes dhe pagesës së kompensimit nga neni 21, paragrafi 1, alineja 1 e këtij ligji.

Neni 24

(1) Lartësinë e kompensimit nga neni 21, paragrafi 1, alineja 1 e këtij ligji që paguhet gjatë importit të derivateve të naftës dhe/ose gjatë prodhimit të derivateve të naftës, përcaktohet në bazë të llojit dhe sasisë së derivateve të prodhuara dhe ose të importuara të naftës.

(2) Lartësinë e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e përcakton në bazë të kritereve në vijim: vëllimit të konsumit të derivateve të naftës, periudhës kohore për formimin e rezervave të detyrueshme të derivateve të naftës, tipit, llojit, sasisë dhe çmimit të derivateve të naftës.

(3) I obliguar për pagesën e kompensimit nga paragrafi 2 i këtij neni është prodhuesi dhe/ose importuesi i derivateve të naftës.

(4) Kompensimin nga paragrafi 2 i këtij neni për prodhuesin e derivateve të naftës e përllogarit vetë prodhuesi, i cili është i detyruar ta paguajë në llogarinë adekuate të pagimit në kuadër të llogarisë së arkës në afat prej 15 ditësh pas skadimit të çdo muaji kalendarik në të cilin janë lëshuar derivatet e naftës në qarkullim juridik dhe e tregon ndarazi në faturë.

(5) Kompensimin nga paragrafi 2 i këtij neni për importuesin e derivateve të naftës e përllogarit organi doganor gjatë pagesës së taksave doganore dhe e paguan në llogarinë e Drejtorisë.

(6) Kompensimi nga paragrafi 2 i këtij neni nuk paguhet nëse sasia e derivateve të naftës që faturohet eksportohet.

(7) Në rastin e paragrafit 6 të këtij neni, prodhuesi i cili e ka faturuar prodhimin është i detyruar që me faturën të deponojë deklaratë doganimi mbi eksportin nga eksportuesi si dëshmi që sasi të derivateve të naftës për të cilat nuk është përllogaritur kompensimi janë eksportuar nga Republika e Maqedonisë.

(8) Në rastin e eksportit të derivateve të naftës për të cilat paraprakisht është paguar kompensimi nga paragrafi 2 i këtij neni, i obliguari ka të drejtë të kthejë kompensimin e paguar për sasinë e eksportuar të derivateve të naftës.

(9) Mënyrën e kthimit të kompensimit nga paragrafi 8 i këtij neni e përcakton ministri i Financave.

Neni 25

Mjetet financiare të pashfrytëzuara nga neni 21 i këtij ligji nga viti paraprak barten për shfrytëzim në vitin e ardhshëm.

Neni 26

(1) Drejtoria është e detyruar të mbajë evidencën e obliguesve për pagesën e kompensimeve nga neni 24 i këtij ligji.

(2) Këshilli drejtues i Drejtorisë i përcakton përmbajtjen, mënyrën dhe afatet për vendosjen, mbajtjen dhe udhëheqjen evidencës së të obliguarve, si dhe mënyrën e parashtrimit të të dhënave për mbajtjen e evidencës.

(3) I obliguari për pagesën e kompensimit, është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e arritjes së obligimit për pagesën e kompensimit, Drejtorisë t'i paraqesë të dhëna për evidentimin e tij, në pajtim me dispozitën nga paragrafi 2 i këtij neni.

(4) I obliguari i regjistruar në evidencë është i detyruar ta njoftojë Drejtorinë për ndërprerjen e punës ose ndryshimin e veprimtarisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së ndryshimeve.

V. MBIKËQYRJA

Neni 27

(1) Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve për magazinim e kryen Drejtoria.

(2) Mbikëqyrjen nga paragrafi 1 i këtij neni e kryejnë personat e autorizuar nga rendi i të punësuarve në Drejtori në bazë të autorizimit me shkrim nga drejtori i Drejtorisë.

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes Drejtoria mund të angazhojë edhe persona tjerë profesionistë nga sferat relevante për kryerjen e aktiviteteve individuale profesionale.

(4) Mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes e përcakton drejtori i Drejtorisë.

Neni 28

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së rezervave të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës personat e autorizuar nga neni 27, paragrafi 2 i këtij neni përgatisin procesverbal.

(2) Në bazë të procesverbalit nga paragrafi 1 i këtij neni, personat e autorizuar i dorëzojnë raport me shkrim me propozim-masa për realizimin e parregullsive të konfirmuara, drejtorit të Drejtorisë.

(3) Drejtori i Drejtorisë në kuadër të kompetencave të veta ka të drejtë që me aktvendim t'i urdhërojë shoqëritë tregtare ta përshtatin punën e vet me kushtet e parapara me këtë ligj, aktet nënligjore dhe marrëveshje, në afat më së shumti prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit me të cilin parashihet masë e tillë.

(4) Kundër marrjes së aktvendimit nga paragrafi 3 i këtij neni, shoqëritë tregtare kanë të drejtë të ngritin procedurë para gjykatës kompetente.

(5) Personat e autorizuar të cilët në kryerjen e mbikëqyrjes do të konstatojnë se ka elemente të kryerjes së veprës penale, janë të detyruar që për këtë t'i dorëzojnë raport drejtorit të Drejtorisë për ngritjen e procedurës para organit kompetent.

Neni 29

(1) Mbikëqyrjen inspektuese të dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji e kryen Inspektorati shtetëror për inspektim teknik dhe Inspektorati shtetëror i tregut në pajtim me kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj.

(2) Kundër marrjes së aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, shoqëritë tregtare mund t'i deklarojnë ankesë në afat prej 15 ditësh Komisionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për kryerjen e punëve administrative të shkallës së dytë nga sfera e energjetikës.

VI. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 30

(1) Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 25 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- refuzon të ruajë rezerva të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës (neni 7, paragrafi 1);

- rezervat e detyrueshme i shfrytëzon si mjete për sigurimin e kërkesave ndaj personave të tretë, pengut, ose çfarëdo lloji tjetër të sigurimit (neni 10, paragrafi 2);

- nuk mundëson kontrollin e rezervave të detyrueshme dhe nuk e vë në kontroll dhe në dispozicion dokumentacionin në lidhje me punën me rezervat e detyrueshme (neni 10, paragrafi 3);

- nuk e tregon kompensimin ndarazi në faturën e përcaktuar në nenin 24, paragrafi 4 i këtij ligji;

- nuk e paguan kompensimin në pajtim me këtë ligj, në mënyrë dhe në afatet e përcaktuara në nenin 24, paragrafët 4 dhe 5 të këtij ligji;

- nuk i dorëzon të dhënat për evidentimin në kushtet dhe afatet e përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji.

(2) Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i kumtohet gjobë në shumë prej 1000 deri në 3000 euro me kundërvlerë në denarë për kundërvajtje edhe personit përgjegjës te personi juridik.

(3) Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, krahas gjobës, personit juridik do t'i kumtohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë energetike adekuate në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh deri në tre vjet.

Neni 31

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 30 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje kumton gjykata kompetente.

Neni 32

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 30 të këtij ligji, Drejtoria është e detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim para se të parashtrijë kërkesë për procedurë për kundërvajtje.

(2) Kur kryerësi i kundërvajtjes është pajtuar për ngritjen e procedurës për barazim, Drejtoria përpilon procesverbal në të cilin theksohen elementet e rëndësishme për kundërvajtjen, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat që gjenden në vendin e ngjarjes dhe mënyrën me të cilën do të evitohen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja.

(3) Drejtoria në procedurën për barazim, kryerësit të kundërvajtjes mund t'i japë urdhërpagesë.

(4) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën është i detyruar që të njëjtën ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

(5) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën e nënshkruan personi zyrtar, gjegjësisht personi përgjegjës, i cili është gjendur në vendin e ngjarjes gjatë kontrollit ose personi tjetër zyrtar ose personi përgjegjës që ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhërpagesën.

(6) Deklarata nga paragrafi 5 i këtij neni shënohet në procesverbal.

(7) Drejtoria është e detyruar të mbajë evidencë për procedurat e ngritura dhe për rrjedhën e tyre.

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 33

(1) Drejtoria do të fillojë me punë me emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe drejtorit të Drejtorisë.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë do t'i emërojë anëtarët e Këshillit drejtues dhe drejtorin e Drejtorisë në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

(3) Deri në fillimin me punë të Drejtorisë, Agjencia për rezervat e mallrave do t'i kryejë punët në kompetencën e vet.

(4) Këshilli drejtues i Drejtorisë do të miratojë statutin e Drejtorisë në afat prej 30 ditësh nga dita e emërimit të anëtarëve të Këshillit drejtues.

(5) Mjetet dhe prona, si dhe të drejtat dhe obligimet e Agjencisë së rezervave të mallrave që kanë të bëjnë me kryerjen e punëve në kompetencë të Drejtorisë, i barten Drejtorisë.

(6) Të punësuarit në Agjencinë e rezervave të mallrave të cilët kanë kryer punë në kompetencën e Drejtorisë, i ndërmerr Drejtoria në pajtim me aktet e veta për organizim dhe sistematizim.

(7) Mjetet e nevojshme për punën e Drejtorisë për gjashtë muajt e parë nga fillimi i punës, do të sigurohen prej mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, në seksionin e Agjencisë për rezervat e mallrave.

Neni 34

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat nga nenet 102, 103, 104, 105, 151 dhe 153, pika 37 nga Ligji për energjetikë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 63/2006, dhe 36/2007).

Neni 35

Dispozitat e parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në ("Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"), ndërsa do të fillojë të zbatohet pas skadimit të gjashtë muajve nga dita e hyrjes së tij në fuqi.